



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), Tel: +35522400150

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_/ \_\_\_\_/ 2017

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

(Kopje e përmbledhur e cila do të publikohet në buletin)

Autoriteti Kontraktor: Adresa, nr. tel: Bashkia Shkodër L. "Vasil Shanto", Rr. "13 Dhjetori", tel+35522400150.

Lloji i procedurës së prokurimit: Kerkese per propozim (prokurim publik me mjete elektronike).

Objekti i prokurimit ( nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): "Rikonstruksion rruga Oblikë-Velinaj-Alimetaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagjja Garuc)".

Fondi limit ( nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): 6 715 744 lekë pa TVSH.  
Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkise.

Vlera e shpallur fituese (nqs ka lotë e ndarë sipas loteve): 4 243 748.35 lekë pa tvsh.

Data e zhvillimit të tenderit: data 09.01.2017 ora 12.00 vendi: Njesia e Prokurimeve Publike, Bashkia Shkodër.

Operatori/et ekonomik i/të shpallur fitues: "Rroku GUEST" sh.p.k. Adresa: Adresa: Dedaj, Shkrel-Malesi e Madhe, NIPT-i K 87921701 H.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
VOLTANA ADEMI  
NE MUNGESË DHE ME POROSI  
ZV/KRYETAR  
EMILJA KOLIQI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), Tel: +35522400150

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Ref. **2141-001**

**Data 22 / 02 / 2017**

**Nga:** Bashkia Shkodër. Adresa: L. "Vasil Shanto", Rr. "13 Dhjetori", Tel & Fax +35522400150

**Për:** "Rroku GUEST" sh.p.k. Adresa: Adresa: Dedaj, Shkrel-Malesi e Madhe, NIPT-i K 87921701 H.

-Proçedura e prokurimit: Kerkese per Propozim.

-Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksion rruga Oblikë-Velinaj-Alimetaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagjja Garuc)"

Fondi limit (nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve): 6 715 744 lekë pa TVSH.  
Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkise.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

-Afati i përfundimit të punimeve: 30 dite kalendarike.

-Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike datë 30.12.2017 nr.52.

Data e zhvillimit të proçedurës së prokurimit: 09.01.2017, ora 12.00.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në proçedurë keta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1-Operatori ekonomik "Rroku GUEST" sh.p.k**, me NIPT-i K 87921701 H, me administrator z.Rrok Gega perfaqesuar me prokure te pergjithshme nr.233 rep,nr.182 kol,date 13.04.2016 nga z.Valentin Gega .

Vlera **4 243 748.35** leke pa tvsh (Katermilion e dyqind e dyzet e tremije e shtateqind e dyzet e tete pike 35 leke)

2.Operatori ekonomik **“Karl Gega Konstruksion”sh.p.k** perfaqesuar nga administratori z.Hartjan Sallaku me NIPT-i J 66703076 W

Vlera **4 720 152** leke pa tvsh (Katermilion e shtateqind e njezetmije e njeqind e pesedhjete e dy leke)

3-Bashkimi i operatoreve ekonomik **“S.M.O Vataksi” sh.p.k.&“S.M.O Union” sh.p.k** perfaqesuar me prokure te posacme nr.27 Rep,Nr.16 Kol date 09.01.2017 nga operatori ekonomik **”S.M.O. Vataksi” sh.p.k** perfaqesuar nga administratori z.Xhevat Vataksi me NIPT-i L 47022001 J

Vlera **4 784 337** leke pa tvsh (Katermilion e shtateqind e tetedhjete e katermije e treqind e tridhjete e shtate leke)

4-Operatori ekonomik **“Sark”sh.p.k** perfaqesuar nga administratori z.Arben Kajolli, me NIPT-i K 52531415 H

Vlera **4 809 473** leke pa tvsh (Katermilion e teteqind e nentemije e katerqind e shtatedhjete e tre leke)

5-Operatori ekonomik **“Delia Impex sh.p.k** perfaqesuar nga administratori z.Mario Delia me NIPT-i K 57123001 R

Vlera **5 246 074** leke pa tvsh (Pesemilion e dyqind e dyzet e gjashtemije e shtatedhjete e kater leke)

Ka ofertues te skualifikuar.

1-U skualifikua operatori ekonomik **“Karl Gega Konstruksion“ shpk** per keto arsye:

a)Bazuar në kriteret e shpallura në DST kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë përvoja të mëparshme të punëve të kryera gjatë 3 viteve të fundit, përmes kontratave të ngjashme, të cilat vërtetohen me:

- *Kontratë sipërmarrje*
- *Situacion Përfundimtar*
- *Akt kolaudimi*
- *Certifikatë e marrjes në dorëzim*

Ju keni paraqitur një kontratë me Komunën Bushat të datës 14.02.2011, sipas certificates së marrjes në dorëzim puna ka përfunduar në 25.02.2014, në dokumentacionin e paraqitur mungon akti i kolaudimit.

b)Pas verifikimit në sistem të certifikatave ISO me datë 10.01.2017, në adresën [www.rig-cert.com](http://www.rig-cert.com) rezulton se:

- ISO 9001:2008 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë” është e anuluar;
- ISO 14001:2004 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” është e anuluar;
- BS OHSAS 18001: 2007 mbi “Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”, është e anuluar;
- PAS 99-2012 mbi "Sistemet e menaxhimit te integruar", nuk rezulton.

c)Kontrolli teknik i kamionit me targa SH 8512 D ka skaduar me dt. 20.12.2016, gjithashtu edhe Siguracioni me dt. 08.12.2016.

d)Për asfaltoshtruesen, nuk është e lexueshme fatura ose vërtetimi i zhdoganimit.

2.U skualifikua bashkimi i operatoreve ekonomik **“SMO Vataksi” shpk** me **“SMO Union” shpk.** per keto arsye:

a) Sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 24/13, dt. 090.1.2017 mes SMO Vataksi dhe SMO Union, në të dyja është përfaqësues ligjor Xhevat Vataksi. Në lidhje me SMO Union përfaqësimi bazohet në prokurën e posaçme me nr. 25/14, dt. 9.1.2017, sipas të cilës *“I përfaqësuari SMO Union shpk emëron përfaqësues të posaçëm shoqërinë SMO Vataksi shpk përfaqësuar nga Xhevat Vataksi”*. Në bazë të nenit 67, të K.Civil të R.Sh sipas të cilit: *“Përfaqësuesi nuk mund të kryejë veprime juridike në emër të të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, përveç kur i përfaqësuari e ka lejuar këtë shprehimisht, ose kur përmbajtja e veprimit juridik nuk çënon interesat e tij.* “Për sa më sipër, rezulton se veprimi i kryer nga z. Vataksi bie në kundërshtim me dispozitat e Kodit Civil.

b) Shtojca nr. 8, që lidhet me disponueshmërinë e mjeteve është plotësuar nga deklaruesi Xhevat Vataksi, i cili e ka nënshkruar atë si përfaqësues i SMO VATAKSI sh.p.k ndërkohë që (teksti) përmbajtja e saj është për SMO UNION sh.p.k.

c) Si punë të ngjashme:

- Kontrata mes FZSHH dhe SMO Union shpk & Curri shpk, si bashkim operatorësh me objekt: “Rikonstruksion rruge Qerret – Karpet”, e lidhur me dt. 10.06.2013, punimet kanë përfunduar me dt. 25.09.2014 sipas situacionit perfundimtar me vlerë 166,356,247 lekë, e realizaur 100 % nga SMO Union. Në dokumentet e paraqitura mungon akti i kolaudimit.
- Kontratë mes Bashkisë Malësi e Madhe dhe SMO Vataksi & SMO Union, me objekt: Sistemim asfaltim rruga e Reçit”, me vlerë 59,100,911 lekë, rezulton se në dokumentacionin e paraqitur mungon marreveshja e bashkëpunimit mes SMO-ve dhe në këto kushte nuk dihet se cila është përqindja e bashkëpunimit.

d) Sipas DST, operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, deklaratë e cila nuk është paraqitur nga ana juaj.

e) Per operatorin SMO UNION, ISO 9001:2008 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë” dhe PAS 99-2012 mbi “Sistemet e menaxhimit te integruar” nuk rezultojnë në adresën [www.qcb.it](http://www.qcb.it).

3.U skualifikua operatori ekonomik **“SARK” shpk** per keto arsye:

a) Vërtetimi i OSHEE është lëshuar për kontratën e energjisë në emër të Sabri Kajollit, ndërkohë që admisnitrator për Sark sh.p.k është Arben Kajolli, vërtetimi i paraqitur nuk tregon se Sark shpk nuk është debitorë ndaj OSHEE.

b) Si punë të ngjashme keni paraqitur:

- Kontratën me Bashkinë Has, dt. 22.8.2016, objekti i kontrates: “Blerje çakulli dhe shpërndarje me makineri si dhe riparime të tjera të rrugëve rurale” me vlere 6,900,120 leke, objekti i kësaj kontrate nuk është i ngjashëm me objektin tonë të prokurimit. Pasi me bashkinë Has është prokuar mall +shërbim, ndërkohë objekti i jonë i prokurimit është punë.

- Kontratë me Këshillin e Qarkut Berat, dt. 10.04.2014, me objekt "Riparime rruga rurale dhe komunale Skrapar", me vlere 2,643,036 lekë, vlere e kësaj kontrate është më të vogël se 3,768,183 lekë e përcaktuar në DST-të tona.

c) Në kriteret e shpallura në DST kërkohet që *operatori ekonomik ofertues duhet të ketë te punësuar te pakten 1 (nje) inxhinier ndertim 1 ing. hidroteknik dhe 1(nje) inxhinier topograf. Inxhinieret duhet të jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig.*

Rezulton se Ing. Gjeodet F. Sema mungon në listpagesat e shoqërisë tuaj që në janar të vitit 2016, që dmth se ky ing nuk është në dispozicionin tuaj.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **"Rroku GUEST"** sh.p.k me administrator z.Rrok Gega, se oferta e paraqitur me nje vlere te pergjithshme prej **4 243 748.35** leke pa tvsh (Katermilion e dyqind e dyzet e tremije e shtateqind e dyzet e tete pike 35 leke) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Njesise se Prokurimeve Publike, Bashkia Shkodër, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) /, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në date 25.01.2017.

Ankesa: Ka patur.

Me shkresen nr.1242 prot date 30.01.2017 ka paraqitur prane Autoritetit Kontraktor Formularin e Ankeses operatori ekonomik "Sark" sh.p.k.

Me shkresen nr.1242/1 prot date 06.02.2017 nga Autoritetit Kontraktor i eshte kthyer pergjigje ankimit te ketij operatori.

Ky operator nuk ka paraqitur ankese prane Komisionit te Prokurimit Publik.

Jane respektuar afatet ligjore te ankeses prane Komisionit te Prokurimit Publik.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
VOLTANA ADEMI  
NE MUNGESHE DHE ME POROSI  
ZV/KRYETAR  
EMILJA KOLIQI**

